

JAMË SHQIPTARË I DORZUAR

Jamë shqiptarë unë i dorzuarë
Musliman musliman musliman
Zotit t'madh e të adhuruar
Muslimanë.muslimanë.muslimanë

Allahu ne na ka krijuar, mendje e shpirtë na ka dhuruar
Vetëm Atë e adhuroj, ligjin e Tij e zbatoj

Jam njeri si gjithë njerëzimi-Muslimanë...
Më bënë krënar mua besimi-Muslimanë...

Allahu ne na ka krijuar, mendje e shpirtë na ka dhuruar
vetëm Atë e adhuroj, ligjin e Tij e zbatoj

Nëse dëshiron shpëtimin bëhu ti Muslimanë...
Bëji vehtes frenimin që të jeshë muslimanë...

Allahu ne na ka krijuar mendje e shpirtë na ka dhuruar
Vetëm Atë e adhuroj ligjin e Tij e zbatoj

MERIMANGA

Është shembulli i madh
I kësaj krijesë të vogël
Argument nga Allahu
Mos mendo se është lodër

As rastësisht kjo krijesë
Nuk ka ardhur në këtë botë
As më të mëdha as më të vogla se kjo
Nuk janë të krijuara kotë

Besimtarët e mençur
E dijnë dhe e besojnë
Këtë argument nga Allahu
Plotësisht e pranojnë

Kurse ata që fshehin
Të vërteten në shpirtin e vetë
Shumë argumente të Allahut
Nuk munden më t'i gjetë

O ti që nuk po kupton
Unë po të japë një izë
Pasi që mëndon se je i zoti
Krijoje pra vec një mizë

BLETA

Punëtore e palodhëshme
Viziton fushën e malin
Ndalon lule më lule
Për të grumbulluarë nektarin

Në hojet e tyre
Bënë një mrekulli
Mjaltin e mbledhur
I sherueshëm për kënaqësi

Çdo ditë ajo fluturon
Çuditësh sa kilometra kalon
Punë punë e vetëm punë
Kurrë ajo nuk pushon

Instikt I ka dhënë Allahu
Dhe e përmendë në Kur'an
Asnjë njëri në botë
Punë si ajo s'mund të banë

Bënë ajo çfarë bëjnë
Allahun falenderon
Për dhuntinë që ia dha
Gjithmonë ajo punon

HËNA

Dritën e Diellit
Qartë e rëflekton
Atëherë kur reja
Nuk e pëngon

Hëna e re
Hareshëm kur ndriqon
Si drapër në hapësirë
Fillimin e muajit tregon

Si pasqyrë merr rrezet e Diellit
Dhe neve na bënë dritë
Netët ërrësohen nga perëndimi
Dhe hëna i bënë dritë

Rruga e saj ndryshon
Por kurrë nuk mund të gabon
Dymbëdhjet orë në vit
Më pak ditë numëron

DIELLI

E ka krijuar Allahu
Për ne me shumë dobi
S'do të mund të shihnim
Pa dritën e tij

Kur lindë në agim
Është një mrekulli
As bimë as kafshë
S'munden pa dritën e tij

Rrugën e tij të caktuar
Kurrë që s'mundë ta ndryshon
Me urdhërin e Allahut
Lindë e perëndon

Më të mund të orjentohe mi
Për namazin –kohët e tij
Është betuar në të Allahu
Do të thotë se ka shumë rëndësi

TOKA

Qiellin ua krijova kulëm
E tokën vend banim
E sqaron Allahu në kur`an
Me plotë argumentim

Çdo gjë e ndërtuar në këtë botë
Shenjën e prodhuesit e ka
Toka është shumë e vjetër
E ka krijuar I madhi Allah

Nga toka jemi të krijuar
Në të do të rikthehemi
Por prap nga toka do të ringjallemi
E me Alahun do të takohemi

Na krijoi Allahu
Sundues në këtë planet
Me punë të pa lodhëshme
E bëjmë sikur xhenet

QIELLI

Ngrisim kokën lart e vërejmë
Me kujdes tërë këtë mrekulli
Allahu për ne e ka bërë mburojë
Këtë krijim me fuqinë e Tij

Dielli Hëna dhe Yjet
Qieillin e zbukurojnë
Trupa të shumtë qiellorë
Në të ekzistojnë

Sikur kulëm e ka krijuar
Allahu me dijen e Tij
Nga Qielli bije begatija
Gjallëruesi që ne e quajmë shi

Sipas fjalëve të Allahut
Shtatë qiellra janë krijuar
Ndoshta sot s'i kuptojmë
Por shkenca mund t'i zbulojë

UJI

H₂O-nga Kimia
Formulën ia kemi mësuar
Për të ka nevojë gjithësia
Pa të jeta ska të ekzistuar

Nga Toka e Qielli
E ke burimin
Më mirë se cdo gjë
Uji bënë pastrimin

“DHE PREJ UJI I KEMI DHËNË
ÇDO GJËJE JETË”
Tha Allahu në Kur'an
Librin e vetëm të vërtetë

I shijshëm e I pijshëm
Dhe me shumë dobi
Pa të nuk kanë jetë
Bimë kafshë e as njëri

Argument nga Allahu
Për cdo kë që logjikon
Kush përvec Tij
Ka mundë ujin t'a krijon

SHIU

Nga retë në qiellë
Ne tokë pikon
Gjithcka të vdekur
Shiu i gjallëron

“Dhe nga qielli lëshojmë shiun
Furnizim për ju
Mos sillni për Allahun ndihmtarë
Se shiu është nga Ai këtë e dini ju”

Era l shtynë retë
Nga dëshiron Allahu
Mos mendo se shiu bije si donë vetë
O njëri lumë vëllau

Askush në botë
S’mundet ta ndalojë
As kur të bije ai
S’mundet kush ta caktojë

Nimet prej Allahut
Mëshirë për cdo gjallesë
E din Ai vet ku dhe kur do të bijë
Hiqe ti atë vesves

NATA E KADRIT

Natë e madhe me rëndësi
Nata e Kadrut mrekulli
Të zbres Kur’ani ka fillu
Gjithë njerëzimin me e drejtu

Zgjohu zgjohu ore vëlla
Për këtë natë ibadet me ba

Vlerë të madhe kjo natë ka
Kush e dinë pos një Allah
Zbret Xhibrili me të tjerë melek
Duhet t’jemi duke bërë ibadet
Refreni... zgjohu...

Njëmijë muaj vlerën ka
Në këtë natë Kur’ani në tokë ka ra
Nata e kadrut është shpëtim
Paqë e mëshirë deri n’agim

Refreni... Zgjohu...

SHPALLJA E KUR'ANIT

NË NATEN E KADRIT
Të zbres Kur'ani filloi
Të mirën nga e keqja
Qartë që ta dalloj

Udhëzues për njerëzit
Sqarues i vërtetë
Lumturinë në këtë botë
E në ahiret me gjetë

Udhërrefyes i qartë
Jetën si me ndërtu
Njeri, na ka krijuar Allahu
Dhe duhet që me u dallu

Jashtë korrnizave të tij
Po që se largohesh
Kurrë në jeten tënde
Nuk do të rehatohesh

I zbritur nga Allahu
Sundues e krijues i të gjithave në këtë botë
Kur'ani i saktë është fjalë e vërtetë
Ai vet e ka mbrojtë

JAMË MUSLIMAN

Kudo që të shkoj
Kushdo le ta dijë
Allahun e rrëspektoj
Zbatoj ligjin e Tij

Unë jam muslimanë
Vetëm Allahun adhuroj
Me zemër gojë e mendje
Këtë e dëshmoj

I lumtur në këtë botë
I shpërblyer në ahiret
Vetëm për muslimanin
Allau ka krijuar xhenet

Kushdo që të vijë
Një ditë do të shkojë
Feja e pastërt islame
Kurrë nuk do të ndryshojë

Dëgjoni o njerëzit e botës
Dy fjalë dua me ju thanë
Pavarësisht si ju doni
Unë jamë muslim

KUR'ANI

Libër I saktë nga Allahu -Pa dyshim
T'I përmbahesh atij gjenë shpëtim

Nuk është satelit
Por tërë botën e mbulon
Prej lindjes në perëndim
Prej veriut në jug

Për ti kapur valët e tij
S'është kush ka mjete e para
Vetëm logjikë e mendje të shëndoshë
Lexoje,lexoje, shpesh lexoje
Vetëm të vërtetën Kur'ani mbrenda e ka

Të krahasuar më të
Libër në botë nuk ka
Cdo gjë që vyen ne këtë jetë
Mbrenda përmbrenda Kur'ani ke me gjetë

Këshillë e shpeshtë e tij
Është për të mësuar
Afër Një mijë herë për këtë thërret
Mësoje të vërtetën të mos jeshë I ndikuar

Fjala e parë e tij
Është fjala IKRE
Kurse ajo e fundit
"Vetëm islami për ju të jetë fe"

SUREJA DHE AJETI

Sureja është kaptinë
Që disa ajete I ka
Ajeti një fjali
Lexoje Kur'anin që me i pa

Fjalë të bukura e të mrekullueshme
Që Allahu në tokë I ka zbritë
Që të marrë mësim gjithë njerëzia
Të dalë nga errësira në dritë

Askush në botë nuk ka mundësi
Si kur'ani të bëjë mrekulli
Dera e hapur ende qëndron
Kush dëshiron le të vështron

As dhjetë sure e as një
Që kur'ani ka 114-të
Nuk do të mundet kurrë njeriu
Që ta shkruajë as dhe një ajet

HADITHI

Sunet apo hadithë
Fjalë gjurmë apo porosi
Nga Muhamed Alejhi selami
Dedikuar për gjithë këtë njerëzi

Pejgamberi Muhamed
Kshillat që I ka dhënë
Fjalë të qarta të kuptueshme
Shembull si të jemi muslimanë

Porosi e tijë e artë
Merr mësim cdo njeri
Pëlqimi I ndonjë veprë
Që është bërë para tij

Fjalët e Resulu Ilahut
Pëlqimi dhe vepra e tij
Quhen hadithi
Me kategoritë e tijë

ERDHA NË XHAMI

Erdha n'Xhami bismilah
Ty po të lutem o Allah

Diturinë mua m'a shton
Ta kuptoj fenë tonë

Nënë e babë t'I rrespëktoj
Vepra të mira të punoj

Erdha n'Xhami bismilah
Ty po të lutem o Allah

Kur'anin mirë t'a mësoj
Në orgjinalë ta lëxoj

Edukaten e fesë islame
Në xhami, në shtëpinë Tënde

Refreni.Erdha n'Xhami bismi lah
Ty po të lutem o Allah

Ti o hoxhë mua më ndihmo
Me fjalë të buta më këshillo

Në këtë vend të bukur e të shenjët
Që t'a mësojmë rrugën e drejtë.Ref...

Të jemi me moral e educate
Muslimanë në shkallë të lartë

Melekët për ne të bëjnë dua
Duam xhenetin për me pa.Ref...

Prindërit e mi Allah m'i shpërble
Mundësoji në xhenet të hynë

M'i ruaj motrat e vëllazërinë
Të afërmit dhe të gjithë shoqërinë

Do të mosojë pa përtesë
Do t'ia lajmë borgjin fesë.Ref...

Erdha n'xhamij bismi lah
Ty po të lutem o Allah

Namazin për ditë duke e falë
Para Teja të dalim faqebardhë

Dritën tëndë këtu më marrë
Punët e mija të shkojnë mbarë .Ref...

Në cdo sferë të jetës sime
Nga Ti të kemë vec bekime

Mjaft punëtore në përgjithësi
Që të kemi shumë dobi

Erdha n'xhamij bismi lah
Ty po të lutem o Allah

KUR'ANI MREKULLI

Nuk ka fjalë që mundë ta shprehë kuptimin e tij
Nuk ka gjuhë që mundë t'i sqaroi fjalët e tijë
Nuk ka shprehje që mundë t'i krahasohet atij
Fjala e Allahut Kur'ani mrekulli.

Prej kur bota është krijuarë
Gjërat më të rëndësishme i ka sqaruar
Çdo dije të botës na ka mësuarë
Mësimi nga kur'ani nuk ka të përfunduarë.

Fjalë e bukur dhe e shenjtë dyshim nuk ka
Që kurrë shkenca n'fund nuk mudet m'i ra.

Është fjalë e Ati që krijoi qijejë e tokën
Dijetarët me të nuk ngopen
Kur'ani ndau të vertetën dhe të kotën
Aktual është në çdo kohë dhe për tërë botën.

Me leximin e tij

Besimtarët bëhen të devotshëm
Të sëmurit bëhen të shërueshëm
Të pa udhëzuarit të udhëzueshëm
Pabesimtarët të mposhtëm.

NE E LEXOJMË KUR'ANIN

Recital përshtatur për fëmijët me rastin e Programit "ARDHËRIA E XHAMISË 3" Që do të mbahet në Oslo 26 maj 2007

Eudhu bi lahi mine shejtani rraxhim
Bismilahi rrahmani rrahim
I mbështetemi Allahut
Që t'na ruaj nga shejtani i mallkuarë
Me bismilah me emrin e Allahut
Tani leximin e Kur'anit kemi mësuarë.

Nga hoxha ynë i dashur
Edukatën Fetare kemi mësuarë
Të jemi të sjellshëm
Nënë e babë për t'i dëgjuarë.

Ta besojmë Allahun
Që na ka krijuarë
Ai na shehë e na dinë
Të gjitha çka kemi punuarë.

Kemi mësuarë shehadetin
Dëshminë se jemi muslimanë
Edukatën më të mirë
Dhe dijmë të lexojmë kur'an.

Neve na donë Allahu më shumë
Edhe Muhamedi Alejhiselam
Sepse jemi të edukuarë
Dhe nuk bëjmë haram.

Kemi mësuarë në xhami
Si të sillemi në shtëpi
Ta flasim gjuhën tonë amëtare
Na urdhëron edukata fetare.

Të lexojmë shumë e të mësojmë
Traditën tonë mos ta harrojmë
Familjen shumë ta dojmë
Të gjithë njerëzit t'i respektojmë.

Përshendetjen më të mirë në botë

Në xhami e kemi mësuarë
Selam alejkum, alejkum selam
Allahu kështu ka urdhëruarë.

Ta mbajmë pastërtinë pa përtësë
Kemi mësuar t'marrim abdesë
Duaja jonë të na pranohet
Familja jonë duhet të gëzohet.

Kemi mësuar lutje
Dua e ilahij
Allahu na ka krijuar
T'i përulemi atij.

Vetëm Një Zot është
Që të gjitha i ka kriju
Vetëm Atë e adhurojmë
Ndihmë vetëm prej Tij kërkojmë.

O Allah më i madhi
Që gjithçka është e Jotja
Falna babë e nënë
Rahmeti është mëshirë e jotja.

Po te lutemi Ty
Që ke urdhëruar Islamin
Duanë me na pranu
Se ne e lexojmë Kur'anin.

ERDHA N'XHAMI

Erdha n'xhami fenë e Allahut me mësu
Edukatën fetare që Allahu ka urdhëru.

Mësova se dikush më krijoi
Të gjitha m'i dha të jetoj
Jamë njeri krijesë e zojë
Krijuesin tim e falenderoj.

Mësova se jamë musliman
Të gjithë muslimanët vëllëzer e motra i kam
Mësova se shqipëtarë jamë
Ta ruaj kulturën time borgj e kamë.

Mësova rrugën e drejtë të integritit
Të ecë me botën përmes besimit
Të jemë largë vetive të shkatërrimit
Mësova qëllimin e krijimit.

Erdha në xhami të marrë dituri
T'i dua prindërit e mi
Këtu gjeta shumë shoqëri
E mësoj islamin në norvegji.

KRENARIJA JONË

Allahu i madhë me krijoi shqiptare
Jamë muslimane e qëndrojë krenare
Vijë nga populli I lashtë ilir
E kamë islamin fenë më te mirë.

Islami feja e Allahut xh.sh.
Ai e ka porositur që të gjitha I ka kriju
Të gjithë peygamberët për këtë i ka dërgu
Besimin në Një t'vetmin Allah me besu.

Allahu i mëshiroftë ata që islamin na kanë pru
Edhe të parët tanë që e kanë pranë
Prindërit e dashur që na kanë eduku
Dhe hoxhtë që n'xhami na kanë mësu.

Muslimane jamë krenare e lumtur
Muslimane do të jemë e palëkundur
Muslimane do të jemë kudo e gjithmonë
Islami është krenarija jonë.

UNË E LEXOJË KUR'ANIN

Gëzohuni shumë gëzohuni o prindërit e mi
Unë kur'anin ta lexojë mirë di.

Edhe ju nga leximi im keni dobi
Çdo natë e lexojë kur'anin në shtëpi.

Unë e lexojë kur'anin
Fjalën e Allahut
Do t'ia mësojë edhe të tjerëve
Motrës edhe vëllaut.

E lexoj kur'anin original
Ashtu si ka zbritur
Me leximin e tij
Zemra më është ndritur.

Me kur'anin jamë I edukuar më se miri
Edhe do ta lexojë sa të jetë umri
Do t'ia shohë hajrin në këtë dunja
Edhe në ahiret dritën kam me pa.

Ende jamë fëmijë por e kamë kuptuar islamin
Nuk do të gjëndem rrugëve që e kanë haramin
Do të kënaqeni me mua se e kam imanin
Unë e lexojë kur'anin.

E KEMI NJË GJË

E kemi një gjë
Që pakë kush e ka
Shkëlqen si nuri
Por ende nuk e kanë pa.

I ëmbël si mjalti
S'e kanë shijuar ende
Lehtë është ta kuptosh
A nuk ke mendje
Mos jeto kotë.

E kemi një gjë
Që na bënë të lumtur
Të edukuarë
E jo të humbur.

Më të Allahu na ka hapur derën
Shikoni musliman a e dini vlerën.

Nuk po lodh shumë
Vehtëveten e as ju
Lexojeni kur'anin keni për ta kuptu.

BESIMTARI NUK KA STRES

Besimtari nuk ka mërzi
Se I mbështetet Allahut krijuesit të tij
Nuk ka lodhje as demoralizim
Sepse lexon kur'anin për qetësim.

Besimtari nuk ka mundim
Se kur'ani e mëson për durim
Nuk ka vuajtje e dëshprim
Se nga Allahu pret shpërblim.

Besimtari nuk ka gjelozi
Se shejtani është largë atij
E falë namazin pa përtësë
Besimtari nuk ka stres.

KONTROLLOJE VETVEHTËN

Nëse njerëzit nuk të duan
Nëse telashe ke e ti vuan
Shërohesh me të vërtetën
Kontrolloje vetvehten.

Mos nuk je duke falë namazin
Apo s'di fare ta lexosh kur'anin

Mos nënë e babë nuk i rrespekton
Mos me fjalë dikë e mundon.

Nëse njerëzit nuk të duan
Nëse telashe ke e ti vuan
Shërohesh me të vërtetën
Kontrolloje vetvehten.

Mos thuaj :O Allah çka më gjeti
Por ndalu e bëhu i sinçertë
Shërohesh me të vërtetën
Kontrolloje vetvehten.

Fillo tani mirë me mendu
Të ligat krejtë më i harro
Drejtoju Allahut pendohu
Kontrolloje vetvehten
E gjete të vërtetën.

PËRKUJTIM NGA VARGJET

Ti ishe ai që më jepje kurajo
Që unë të qëndrojë në rrugën e Allahut
Ne kohën kur isha i njomë
Dhe shumë më lakonin andej këndeje.

Besim-ishe për mua vullnet
Një këshillë e shembull i fortë
Nga i lumi Allah xheleshanuhu
Që ashtu të ka kriju.

Shpesh mendoja si?
E përgjigjen e gjeja vonë
Aftësinë që ta ka dhënë ty Allahu
Shumë kush do ta dëshiron.

Qofshë i bekuarë
Në këtë natë
E për gjitha netët
Që ma freskove shpirtin.

Me lartësinë shpirtërore
Që Allahu ta ka dhënë
Xhenetin përmbledhës të bukurive
Ishalla e meriton.